



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2020:135813
Datë: 29.05.2024
Numri i dokumentit: 05749705

PPP.nr.66/24

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ - gjyqtari Faton Ajvazi, me sekretaren juridike Makfire Reçica, duke vendosur në kërkesën e kreditorit KEL E. sh.a, me seli në Ferizaj, rr “...”, për përjashtimin e Përmbauesit Privat M.Sh. nga Ferizaj, më datë 29.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET kërkesa e kreditorit KEL E. sh.a, e ushtruar me datë 17.05.2024, me të cilën ka kërkuar përjashtimin e Përmbauesit Privat M.Sh. nga Ferizaj, nga zgjidhja e lëndës P.nr.279/2020 dhe përjashtohet Përmbauesi Privat M.Sh. nga zgjidhja e lëndës përmbaimore P.nr.279/2020.

A r s y e t i m

Kreditori KEL E. sh.a, me datë 17.05.2024, në këtë gjykatë ka dorëzuar kërkesën me shkrim, me të cilën ka kërkuar përjashtimin e Përmbauesit Privat M.Sh. nga Ferizaj nga zgjidhja dhe procedimi i lëndës përmbaimore P.nr.279/2020, me arsyetimin se në rastin konkret me veprimet e tij janë vënë në dyshim paanësia dhe kredibiliteti i përmbauesit privat.

Përmbauesi Privat M.Sh., lidhur me kërkesën e kreditorit për përjashtim, ka dhënë deklaratë me shkrim me datën 27.05.2024, ku në deklaratën e dhënë me shkrim është pajtuar me kërkesën e kreditorit për përjashtim me arsyetimin se nuk ka me kushte për komunikim dhe trajtim të kësaj lënde nga përmbauesi privat.

Gjyqtari individual, duke vepruar sipas nenit 17 dhe 325, par 1 dhe 2, të LPP-së, lidhur me nenin 67 dhe 70, të LPK-së, i shqyrtoj shkaqet dhe pretendimet e kreditorit të paraqitura në

kërkesën e tij për përjashtimin e përmbaruesit privat M.Sh. dhe pas analizimit të pretendimeve në kërkesë, vendosi që kërkesën e kreditorit KEL E. sh.a, për përjashtimin e përmbaruesit privat, ta pranoj si të bazuar, nga fakti se nga thëniet e kreditorit në kërkesën për përjashtim dhe nga deklarata me shkrim e dhënë nga përmbaruesi privat, gjykata ka vërtetuar faktin se kreditori e ka humbur besimin e tij tek veprimet procedurale të përmbaruesit privat në këtë rast dhe konstatoj se janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 67, pika g), të LPK-së, që të përjashtohet përmbaruesi privat M.Sh. nga lënda përmbarimore P.nr.279/2020, dhe si rrjedhojë vazhdimi i ndërmarrjes së veprimeve tjera përmbarimore në këtë rast nga përmbaruesi privat në lëndën përmbarimore P.nr.279/2020, vetëm do të shkaktonte humbje edhe më të madhe të besimit të kreditorit tek Përmbaruesi Privat.

Andaj, kjo Gjykatë, duke i marr parasysh të cekurat më lart dhe në bazë të nenit 17 dhe 325, par 1 dhe 2, të LPP-së, lidhur me nenin 67, pika g) dhe 70, të LPK-së, e pranoj kërkesën e kreditorit dhe e përjashtoj përmbaruesin privat B.T. nga Ferizaj nga zgjidhja e lëndës përmbarimore P.nr.870/20.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

PPP.nr.66/24, më datë 29.05.2024

GJYQTARI

Faton Ajvazi

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi nuk është i lejuar kurrfarë mjeti juridik.